

Çfarë është distanca e sigurt nga personat e tjerë?

Duke mbajtur një distancë të sigurt nga të tjerët, ne ndihmojmë në ngadalësimin e përhapjes së koronavirusit (COVID-19)

Ju jeni një kontakt i afërt ose po ktheheni në shtëpi pas udhëtimit dhe duhet të futeni në

KARANTINË

- Mos shkoni në shkollë apo në punë.
- Mos përdorni transportin publik.
- Shmangni vizitat te të tjerët dhe mos prisni vizitorë në shtëpi.
- Mund të dilni për shëtitje jashtë, por duhet të qëndroni më shumë se 1 metër larg nga personat e tjerë.
- Mund të shkoni në ushqimore apo në farmaci nëse është absolutisht e nevojshme.
- Fëmijët mund të bashkëveprojnë në mënyrë normale me të tjerët në shtëpi, por të ruhet një distancë e mirë mes të rriturve.
- Personat me të cilët jetoni nuk janë në karantinë.
- Nëse keni simptoma të infeksioneve të rrugëve të frymëmarrjes, duhet të futeni në izolim dhe duhet të testoheni.
- Rezultati pozitiv në test do të thotë se duhet të izoloheni në shtëpi.

Këshilla për të gjithë

- Ndiqni higjienën e mirë të duarve dhe etikën e kollitjes.
- Ju dhe familjarët dhe miqtë më të ngushtë mund të socializoheni në mënyrë normale.
- Mbani një distancë të sigurt nga të gjithë përveç familjarëve dhe miqve më të ngushtë, të paktën 1 metër.
- Nëse keni simptoma të infeksioneve të rrugëve të frymëmarrjes, duhet të qëndroni në shtëpi.
- Nëse keni simptoma të COVID-19, duhet të testoheni.

Keni rezultuar pozitiv në testin e COVID-19 dhe jeni në IZOLIM NË SHTËPI

- Qëndroni në shtëpi.
- Mbani një distancë të sigurt nga të gjithë personat e tjerë në shtëpi.
- Përdorni një dhomë dhe banjë të veçantë kur kjo është e mundur.
- Pastrojini shpesh sipërfaqet.
- Kërkojini dikujt që të bëjë pazarin për ju.
- Bini dakord me mjekun tuaj se si duhet ta monitoroni shëndetin tuaj.
- Personat me të cilët jetoni duhet të futen në karantinë.